



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:036387
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05512471

CAP.nr.1209/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen përmbarimore të kreditorit K... me seli në Prishtinë, kundër debitorit H. A me adresë në Mitrovicë, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar nga kreditori kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.45/2023 të datës 10.03.2023, me datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e kreditorit K..., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.45/2023 i datës 10.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet pjesërisht kundërshtimi i debitorit H. A me adresë në Mitrovicë, ashtu që: në pikën II., të dispozitivit shfuqizohet pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.4199/2020 të datës 05.11.2020 për periudhën kohore nga data 24.03.2016 deri me datë 26.12.2018 në shumë prej 3,833.65€ dhe obligohet debitori që kreditorit K... me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për energjinë elektrike të harxhuar për periudhën kohore datë 25.01.2019 e gjer me datë 09.10.2020, t'ia paguaj shumën prej 1,114.86€, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve duke filluar nga pranimi i vendimit e gjer në pagesën definitive të detyrimit.

Kundër aktvendimit të atakuar, ka paraqitur ankesë kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se pala kreditore K... ka parashtruar propozimin për përmbartim, ndaj debitorit H. A, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit të konsumatorit me pretendim se debitori i ka borxh kreditorit, në vlerë prej 4,948.51€ për konsumimin e energjisë elektrike të krijuar nga data 24.03.2016 deri me datë 09.10.2020.

Me urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.4199/2020 të datës 05.11.2020, Përmbartuesi Privat A. M, e ka caktuar përmbartimin, kundër të cilit brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim debitori, duke i propozuar gjykatës që ta pranojë prapësimin si të bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit më të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e miraton në tërësi edhe gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, për arsye se, vendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, për të cilat çështje, gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjyqtari individual gjen se propozimi për përmbartim është parashtruar më datën 05.11.2020, për periudhën kohore 24.03.2016 deri 09.10.2020, ndërsa lartësia e borxhit të kërkuar është 4,948.51€. Gjyqtari i vetëm e miraton vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se, në rastin konkret për periudhën kohore 24.03.2016 e gjer me 26.12.2018 borxhi i debitorit ndaj kreditorit është parashkruar, kjo bazuar në nenin 360.1 të LMD-së i cili përcakton se: "Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: kërkesat për furnizimin me energji elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të

pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”. Ndërsa lidhur me borxhin për periudhën kohore 25.01.2019 gjerë me 09.10.2020 gjyqtari individual gjen se nuk ka vjetërsim të borxhit të debitorit ndaj kreditorit, pasi që afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh me 01.01.2019, ndërsa kreditori propozimin për përmbarim e ka parashtruar me 05.11.2020. Për arsyet e theksuara si më lartë, gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit, ka vendosur që pretendimet ankimore të kreditorit të refuzohen në tërësi si të pa bazuara dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1209/2022, me datë 26.03.2024

GJYKATËSI,
Dr.sc. Rafet Haxhaj